


Edukimi me të drejtat e njeriut



Dr. Ervis MARTANI

Edukimi me të drejtat e njeriut

Pjesa I



EDUKIMI ME TË DREJTAT E NJERIUT

- Edukimi me të drejtat e njeriut (EDNJ) përbën një nga instrumentat kryesorë për krijimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe afatgjatë. Edukimi me të drejtat e njeriut filloi “aktivitetin” e tij që nga adoptimi i Deklaratës Universale të të drejtave të njeriut në 1948.
- Ekzistojnë disa kontekste ligjore ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut si, p.sh., traktatet dhe konventat e OKB-së, të Këshillit të Evropës, të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, të Organizatës së Shteteve Amerikane, të Bashkimit Afrikan. Këto dokumente janë të lidhur me 30 artikujt e Deklaratës Universale dhe kanë si qëllim identifikimin dhe promovimin e normave dhe parametrave mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.
- Plani Botëror mbi Edukimin me të drejtat e njeriut (Montreal 1993), Dhjetëvjecari i OKB-së për Edukimin mbi të drejtat e njeriut, dhe dokumenta të tjerë ndërkombëtarë theksojnë nevojën për t'i dhënë rëndësi të vecantë programeve të edukimit mbi të drejtat e njeriut.

- “Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve, racave dhe besimeve, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.” (Deklarata Universale e të drejtave të njeriut, Neni 26,2)
- “Edukimi për të drejtat e njeriut dhe demokracinë është vetë një e drejtë e njeriut dhe një parakusht për realizimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe drejtësisë sociale” (Kongresi ndërkombëtar mbi Edukimin për të drejtat e njeriut dhe demokracinë, Montreal 1993)
- Edukimi dhe formimi përfshin “të gjitha aktivitetet edukative, formuese, informuese, ndërgjegjësimi dhe nxënie...në çdo nivel, përfshirë edukimin parashkollor, parësor, dytësor dhe universitar, duke pasur parasysh atje ku është e nevojshme dhe lirinë akademike, dhe të gjitha format e edukimit, nxënies dhe formimit, në arsimin publik dhe privat, formal dhe informal. Midis të tjerash ai përfshin formimin profesional, në vecanti trajnimin e trajnuesve dhe të mësuesve, edukimin e vazhdueshëm, edukimin popullor si dhe aktivitetet publike informuese dhe ndërgjegjësuese”(Deklarata mbi edukimin dhe formimin për të drejtat e njeriut, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së 2011)

○

ÇFARË ËSHTË EDUKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT?

- Edukimi për të drejtat e njeriut është një koncept kompleks i cili përqëndrohet në disa parametra ligjorë, njohuri, dhe mënyra për të influencuar sjelljen politike dhe sociale. Edukimi për të drejtat e njeriut përfshin seminare, programe didaktike dhe materiale trajnimi për mesues, profesorë universiteti, studentë, punonjës, agjentë të sigurisë, avokatë, menaxherë dhe të tjerë.
- Një nga elementët kryesorë të edukimit për të drejtat e njeriut është referimi në mënyrë specifike të të drejtat dhe kuptimi i gjërë i tyre, sepse nëse individët nuk njohin saktësisht cilat janë të drejtat e tyre dhe të të tjerëve, nuk do jenë në gjendje t'i mbrojnë apo të luftojnë për to.



Rëndësia e edukimit për të drejtat e njeriut mund të ndahet në tre nivele:

- 1) *Nivelin konjitiv*: fitohen informacione mbi zhvillimin dhe historinë e të drejtave të njeriut, Deklaratën Universale, sistemin evropian për të drejtat e njeriut, sistemet e tjera rajonale, organizatat jo qeveritare.
- 2) *Nivelin emotiv*: kjo do të thotë të jesh i ndërgjegjshëm dhe të ndjesh një lloj përgjegjësie kundrejt dhunimeve të të drejtave të njeriut si përshembull abuzimet dhe mizoritë. Këto padrejtësi zakonisht shkaktojnë emocione dhe shtyjnë individët të reagojnë dhe të bëhen aktivë.
- 3) *Nivelin aktiv*: nxitja e individëve për të përdorur zotësinë e tyre për të luftuar dhunimet e të drejtave të njeriut dhe padrejtësitë (psh. duke përdorur njohuritë mbi sistemet kombëtare dhe ndërkombëtare për tutelimin e të drejtave, duke u bërë pjesë aktive e ndonjë OJQ-je etj)



Qëllimi i EDNJ?

Objektivi parësor i edukimit për të drejtat e njeriut është promovimi i kulturës së respektit dhe të drejtësisë, e cila është në të njëjtën kohë edhe kulturë e të drejtave të njeriut. Lindja dhe historia e zhvillimit të të drejtave të njeriut, bashkë me temat bashkëkohore përbëjnë elementë metodologjikë shumë të rëndësishëm: futja e këtyre elementëve në programet didaktike që u adresohen grupeve të ndryshme mund të çojnë në rritjen e ndërgjëgjësimit për të tejkaluar paragjykimet dhe ndaluar diskriminimet dhe abuzimet e tjera.



PËR TA PËRMBLEDHUR

- Formimi në fushën e të drejtave të njeriut nuk duhet konsideruar si një lëndë e veçantë e ndarë nga formimi tradicional, apo e vendosur marginalisht brenda lëndëve të tjera si historia, qytetaria etj. Formimi mbi të drejtat e njeriut duhet përfshirë në të gjitha kurrikulat dhe duhet të jetë një temë për tu diskutuar sa herë që jepet mundësia. Vetëm një qasje e tillë didaktike do të ndihmonte studentët të përballen drejtpërsëdrejti me të drejtat e njeriut, duke nënvizuar faktin se këta të fundit dhe lëndët e tjera nuk janë në konflikt por janë ngushtësisht të lidhura me njëra tjetrën, përfshirë lëndët teknologjike.



- Edukimi mbi të drejtat e njeriut ka si qëllim të përcjellë aftësitë, njohuritë dhe qëndrimet e nevojshme për të krijuar dhe promovuar një botë pa shkelje të të drejtave. Tentativat për të përfshirë të drejtat e njeriut brenda kurrikulave shkollore janë padyshim një nga metodat më efikase për të shpërndarë këtë filozofi. Shkollat përbëjnë një trampolinë tepër të rëndësishme për të arritur këtë objektiv sepse gjatë aktiviteteve të tyre studentët mund të sensibilizohen për të reflektuar me qëllim:
- Parandalimin e dhunimit
- Mbrojtjen, dhe
- Mbështetjen aktive të të drejtave të njeriut



Evropa, si një rajon i industrializuar, është e inkurajuar të kontribuojë në transformimin e të drejtave të njeriut në një lëndë gjithnjë të pranishme në proceset edukative.

Katër hapa janë të rëndësishëm në mënyrë që të rinjtë të jenë të vetëdijshëm për të drejtat e njeriut dhe rëndësinë për t'i mbrojtur ato:

1. Të mësuarit e rëndësisë dhe nevojës të të drejtave të njeriut: unë, si njeri, kam disa të drejta;
2. Zhvillimi i një ndjenje përgjegjësie kundrejt qenieve të tjera njerëzore: të gjithë kanë të njëjtat të drejta. Unë duhet të respektoj të drejtat e të tjerëve!
3. Inkurajimi për të vepruar! Dhunimet e të drejtave të njeriut nuk mund të pranohen. Çdonjëri duhet të aktivizohet dhe të mbrojë të drejtat e njeriut. Jo të gjithë qëniet njerëzore jetojnë në liri: në shumë pjesë të rruzullit tokësor ekzistojnë dhunime të të drejtave të njeriut.
4. Përfshirja aktive në promovimin e të drejtave të njeriut, si psh pjesëmarrja në organizatat jo qeveritare që kanë në qendër të aktivitetit të tyre promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.




Edukimi me të drejtat e njeriut

Pjesa II

Çfarë janë të drejtat e njeriut?





DROITS
DE L'HOMME

HUMAN
RIGHTS

HAWLIAU
DDYNOL

DRETS
HUMANS

DIRITTI
UMANI

DERECHOS
HUMANOS

TED. ENJERIUT

MENSCHEN
RECHTE

Liv Merle Kantak

Çfarë kuptohet me të drejtat e njeriut?

Të drejtat e njeriut janë të drejtat e
çdo individ si i tillë.



Karakteristikat:
Themelore
Universale
Të padhunueshme
Të padisponueshme

- Të drejtat e njeriut janë të drejtat e individit që i janë dhënë atij për shkak të ekzistencës si qenie njerëzore. Këto të drejta janë të përhershme dhe nuk mund të kufizohen nga shteti. Nga koha e luftës kundër absolutizmit rrjedh edhe karakterizimi i tyre si të drejta "të lindura" dhe të "patjetërsueshme". (...) Thelbi i të drejtave themelore apo i të drejtave të njeriut, janë dinjteti i njeriut, e drejta e shprehjes së personalitetit, trajtimit të barabartë dhe barazisë para ligjit, liria e besimit dhe e ndërgjegjes, e mendimit, e shtypit, e informimit dhe e mësimin, liria e mbledhjes dhe e bashkimit, e zemërgjerësisë, liria e profesionit dhe e punës, pacenueshmëria e banesës, garantimi i pasurisë dhe i të drejtës së trashëgimisë, e drejta e strehimit politik dhe e peticionit, si dhe të drejtat juridike, si garanci kundër arrestimit të padrejtë (...).“ (Wichard Woyke, 1994)



Histori e shkurtër e të drejtave të njeriut (italisht):

<https://www.youtube.com/watch?v=P9u5cOjwRCw>



- Të drejtat e njeriut janë po aq të vjetra sa vetë raca njerëzore. Ekzistonin përpara se ekonomia, shteti, feja, shoqëria të kushtëzonin njerëzimin dhe t'i hiqnin shumë prej të drejtave të tij. Të drejtat e njeriut duhen konsideruar si esenca e çdo qënie njerëzore.



- Të drejtat e njeriut, ashtu sic janë të shprehura në 30 artikujt e Deklaratës Universale, përbëjnë një grup të drejtash universale, të pandashme, të patjetërsueshme, dhe një bashkësi vlerash të vlefshme për cdo qenie njerëzore, pavarësisht formave të qeverisjes, feve, apo ideologjive. Në çdo fe, ideologji, apo filozofi ekzistojnë rregulla që janë të lidhura ngushtësisht me të drejtat e njeriut. Konfuci (551-489 pes) kishte “shpikur” një rregull të artë në mësimet e tij, që është shumë i afërt me urdherimin e filozofit Immanuel Kant: “mos u bëj të tjerëve atë që nuk do që të tjerët të të bëjnë ty”. Ky rregull gjendet në të gjitha fetë e mëdha botërore: islamizmi, krishtërimi, budizmi dhe shumë të tjera.



○ Antikiteti greko romak (Stoa, 300 p.e.s)

Kultura greko romake konsiderohet në përgjithësi si djepi i konceptit perëndimor të njerëzimit, pra edhe si djepi i të drejtave të njeriut. Filozofët greko romake të Stoa-s (300 p.e.s) pohonin se të gjitha qëniet njerëzore janë të karakterizuara nga racionaliteti dhe për këtë arsye ndryshojnë nga kafshët. Nëse një individ bën një jetë racionale atëherë ai duhet të jetojë në harmoni me Zotin dhe natyrën. Cdo qenie njerëzore zotëron një dinjitet të paprekshëm dhe të drejtën për respektin e këtij dinjiteti. Duhet theksuar se Stoa nuk është shprehur asnjëherë kundër skllavërisë dhe “qenie njerëzore” i referohet vetëm pjesës mashkullore të shoqërisë.



○ Ligji natyror kristian (Tommaso d'Aquino, 1225-1274)

Filozofi italian, Tommaso d'Acquino, përfaqësues i skolastikëve, dhe teologu më i madh i Kishës Katolike, ka përmbledhur idetë e Stoa-s. Ai pohonte se Zoti ka krijuar njeriun sipas imazhit të tij. Për pasojë, të gjitha qëniet njerëzore janë të barabarta para Zotit. Tommaso d'Aquino bënte dallim midis të drejtave natyrore dhe “ligjeve pozitive”. Cdo qenie njerëzore ka racionalitet dhe ndërgjegje, për këtë arsye gëzon të drejtat natyrore. Por janë ligjet pozitive ata që qeverisin shoqërinë njerëzore, deri në momentin që nuk janë në kundërshtim me ligjet natyrore. Në këtë rast individët kanë të drejtë të kryengrihen! Sidoqoftë, Tommaso d'Acquino nuk konsideronte pabarazitë në realitetin shoqëror ekzistues: të drejtat e njeriut të dhëna nga Zoti do të garantohen vetëm në botën e përtejme.



○ **Ligji natyror racionalist (Hugo Grotius, 1583-1645)**

Rilindja, Humanizmi, dhe Iluminizmi sollën de-teologjizimin e ligjit natyror. Hugo Grotius, filozof hollandez, pohonte se ligji natyror do të egzistonte edhe pa praninë e Zotit apo të feve. Të gjitha qëniet njerëzore duhet të kenë lirinë për të jetuar jetën e tyre sipas racionalitetit pa pengesat e jashtme apo të brendshme



○ Teoria e të drejtave të njeriut (John Locke, 1632-1704)

John Locke (1632-1704) lidhte ligjin natyror racionalist me traditën angleze të lirisë dhe teorine klasike të të drejtave të njeriut. Locke u mëson njerëzve se ekzistojnë ligje që duhet të respektohen: e drejta e jetës, e drejta për liri, dhe e drejta e pronës, të cilat përbëjnë të drejta natyrore të patjetërsueshme. Sipas Locke njerëzit gëzojnë të drejta natyrore dhe shteti ekziston vetëm me qëllim mbrojtjen e këtyre të drejtave. Pra vetë shteti nuk mund tu heqë qytetarëve të drejtat e tyre natyrore sepse këto të drejta nuk i jep shteti. Të drejtat ekzistojnë para se shteti të krijohej, dhe, nëse, ky i fundit do tu mohonte qytetarëve të tij të drejtat e njeriut, atëherë njerëzit janë të autorizuar për mosbindje.



MOMENTE KYÇE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

- **Magna Charta Libertatum (1215)**
- Marrëveshja e parë e shkruar mbi të drejtat e njeriut është ajo e vitit 1215, kur fisnikët anglezë detyruan John Lacklandi-t tu garantonte atyre mbrojtjen nga abuzimi i ligjit.
- La Magna Charta Libertatum garantonte, midis të tjerash, të drejtat e pronarëve të tokave dhe rregullonte sistemin e ligjeve. U shfuqizuan shumë nga ligjet kundër pronarëve, tregëtia u fuqizua dhe u brojt nga ligje të posacme, njësitë e peshimit dhe matjeve u standardizuan, dhe “Gjykata e çështjeve të përbashkëta” u kthye në një institucion të përhershëm te Westminsterit. Procedurat gjyqësore u thjeshtëzuan dhe dënimet u normalizuan. Asnjë nuk mund të dënohej vetëm në bazë të dyshimeve pa dëshminë e një dëshmitari të besueshëm: Asnjë njeri i lirë nuk mund të arrestohet apo burgoset, t’i hiqen të drejtat apo të mirat e tij, apo të dëbohet...përvecse pas një gjykimi të ligjshëm të të barabrtëve të tij..”(Magna Charta Libertatum, neni 39).
- La Magna Charta Libertatum u ratifikua nga Parlamenti në 1227 dhe përbën që nga ajo dokumentin bazë mbi të cilin bazohet përparësia e Parlamentit ndaj Kurorës. Të drejtat e garantuara nga Magna Charta Libertatum kanë qenë në fuqi për më se 7 shekuj dhe tashmë janë pjesë e common law britani.



- **Deklarata angleze e të drejtave (1689)**
- Ishin anglezët të parët që hodhën hapa përpara në filozofinë e shekullit të 16° e 17°: shkëputën liritë individuale nga shtetësia (John Locke). Karta thekson që individët gëzojnë të drejta të cilat nuk mund të preken pa aprovimin e parlamentit. Ky i fundit është i vetmi institucion që mund të vendosë taksa. Pas “revolucionit të lavdishëm”, Deklarata e të drejtave u aprovua nga parlamenti dhe mbreti dhe mbretëresha pranuan të betoheshin për bindje ndaj ligjeve të parlamentit.
- Deklarata e të drejtave është një nga tre dokumentet e rëndësishëm të aprovuar në ato kohë. Dy të tjerët janë “Akti i tolerancës” i 1689 mbi tolerancën dhe lirinë e besimit dhe “Akti trevjecar” i 1694 që ndalonte mbretin të shpërndantë parlamentit sipas vullnetit të tij.



- **Deklarata amerikane e pavarësisë (1776)**
- Mbreti dhe Parlamenti anglez kishin si qëllim vendosjen e taksave ndaj kolonëve anglezë në Amerikën Veriore me qëllim përdorimin e ketyre të ardhurave për të financuar politikën e brendshme angleze. Kolonët refuzuan këtë dekret me moton: “No taxation without self-determination!” (jo taksim pa autonomi). Me deklaratën e pavarësisë së 4 korrikut 1776 kolonitë u shkëputën nga mëmëdheu. Kjo deklaratë theksonte: “(...) I konsiderojmë si të vetëkuptueshme këto të vërteta se të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë; se nga krijuesi i tyre u janë dhënë të drejta të caktuara të patjetërsueshme, ndër to edhe e drejta për jetë, liri dhe e drejta për të kërkuar dhe gjetur lumturinë; se për sigurimin e këtyre të drejtave, njerëzit kanë formuar qeveritë, pushteti ligjor i të cilave rrjedh nga nga autorizimi i atyre që qeverisen; se është e drejtë e popullit të heqë apo ndryshojë atë formë qeverisjeje, e cila është në kundërshtim me këto qëllime dhe të vendosë një qeveri të re, si dhe ta ndërtojë atë mbi një bazë të tillë, ta organizojë formën e pushtetit të saj në mënyrën që atij i duket më e përshtatshme për garantimin e sigurisë dhe lumturisë së tij (...)”.
- Sidoqoftë, implementimi i të drejtave të njeriut në SHBA mbeti për shume kohë vetëm teorik. Psh, vetëm vite me vonë u shfuqizua skllavëria dhe u aplikua një nga të drejtat me të rëndësishme: e drejta për liri.



○ Deklarata franceze e të drejtave (1791)

- Idetë e Deklaratës amerikane të pavarësisë u sollën dhe në Evropë nga Revolucioni francez. Qytetarët e pasur, tregëtarët dhe zejtarët (Klasa e tretë) luftuan kundër fisnikëve (klasa e parë) dhe Klerit (klasa e dytë) për të arritur barazinë. Deklarata e të drejtave të individit dhe qytetarit e 1791 vendos të drejta natyrore dhe të patjetërsueshme të cilat shërbejnë për të mbrojtur individin nga pushteti i shtetit.
- Neni 1. Njerëzit, që nga lindja janë dhe mbeten të lirë dhe me të drejta të barabarta. Dallimet sociale duhet të bazohen vetëm në dobinë e përgjithshme.
- Neni 2. Qëllimi i çdo bashkimi politik është ruajtja e të drejtave natyrore dhe të patjetërsueshme të njeriut. Këto të drejta janë liria, prona, siguria dhe rezistenca kundër shtypjes.
- Neni 4. Liri do të thotë liri për të bërë çdo gjë që nuk dëmton tjetrin. Ushtrimi i të drejtave natyrore të secilit kufizohet vetëm në kufijtë, të cilët pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë u sigurojnë gëzimin e të drejtave të barabarta. Kufijtë në fjalë mund të caktohen vetëm nga ligji.
- Neni 5. Vetëm ligji ka të drejtë të ndalojë veprimet e dëmshme për shoqërinë. Gjërat që nuk janë të ndaluara me ligj, nuk mund të pengohen dhe askush nuk mund të detyrohet të bëjë diçka që nuk urdhërohet prej tij.
- Neni 7. Kushdo mund të paditet, arrestohet dhe të burgoset vetëm në rastet e caktuara me ligj dhe në format që urdhëron ky i fundit. Duhet të dënohen të gjithë ata që lëshojnë, përpilojnë, kryejnë apo lënë të kryhen urdhëra arbitrare. Sidoqoftë, çdo qytetar i cili kapet apo ftohet në gjyq në bazë të ligjit, duhet t'i bindet menjëherë këtij vendimi. Nëse reziston, ai do të dënohet.

- **Deklarata e Përgjithshme e të drejtave të njeriut (10 dhjetor 1948)**
- Pas ngjarjeve tragjike të luftës së Dytë botërore dhe krimeve të tmerrshme të kryera, përfaqësuesit e 58 shteteve që në atë kohë ishin pjesë e OKB-së, u mbledhën në Paris në 1947 për të hartuar një Deklaratë të Përgjithshme të të drejtave të njeriut. Pjesa më e madhe e përfaqësuesve vinin nga zona kulturore kristiano-perëndimore(37), 6 nga vendet komuniste dhe 5 nga shtete me ideologji dhe besime të ndryshme.
- Në 10 dhjetor 1948 Deklarata e Përgjithshme u adoptua pa asnjë votë kundër. Në harkun kohor nga 1948 deri me sot, të drejtat e njeriut të theksuara në Deklaratë janë bërë tashmë pjesë e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për të gjitha shtetet. Të gjitha traktatet apo deklaratet e tjera mbi të drejtat e njeriut janë të frymëzuara nga Deklarata e Përgjithshme.





THE UNIVERSAL DECLARATION
of Human Rights

Për herë të parë shtetet njohin dhe pranojnë, me një dokument juridik universal, që të gjithë individëve, pa asnjë lloj diskriminimi, iu takon mbrojtja e disa të drejtave shprehimisht të shpallura.

“All human beings are born free and equal in dignity”
(Neni 1)



- Deklarata e të drejtave të njeriut është një kod etik me rëndësi themelore sepse përbën të parin dokument që sanksionon universalisht (pra në të gjithë botën) të drejtat që i përkasin qënieve njerëzore. Idealisht, Deklarata mund të konsiderohet si pikëmbërritja e debatit filozofik mbi etikën dhe të drejtat e njeriut në të cilin janë përfshirë filozofë si John Locke, Rousseau, Voltaire, Kant deri te ata bashkëkohorë.



Deklarata përmban qoftë të drejtat civile dhe politike, qoftë të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

Deklarata gjithashtu përfshin edhe kufizimet në ushtrimin e të drejtave dhe lirive si dhe detyrimet që individi ka kundrejt komunitetit. (neni 29.1).



Edhe pse e adoptuar me rezolutë, pas shumë vitesh, pjesa më e madhe e parimeve të shprehura në deklaratë kanë marrë rangun e së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe për këtë arsye janë të detyrueshme për të gjitha shtetet

Deklarata sidoqoftë është një nga dokumentet juridike më të njohur në botë: teksti i saj është i disponueshëm në më shumë se 300 gjuhë të ndryshme.



Të drejtat e njeriut janë:

- themelore
 - universale
 - të padhunueshmë
 - të padisponueshme
- të çdo njeriu

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik (Neni 15).



Të drejtat e njeriut janë **themelore** sepse kanë të bëjnë me nevojat jetike, spirituale dhe materiale të njeriut.



Janë të drejta **universale** sepse i përkasin çdo qenie njerëzore për vetë faktin se janë të tillë, pa dallim race, ngjyre të lëkurës, gjinisë, gjuhës, besimit, opinionit politik, origjinës kombëtare apo sociale, pasurisë, lindjes apo çfarëdolloj kushti tjetër.



Të drejtat e njeriut janë të **padhunueshme** sepse nuk mund t'i mohohen asnjë qenie njerëzore.

Të drejtat e njeriut janë të **padisponueshme** sepse askush nuk mund të heqë dorë prej tyre, as vullnetarisht.



- **Civile dhe politike** → Liritë
- **Ekonomike, sociale dhe kulturore** → Kushtet e jetesës
- **Te drejtat e solidaritetit** → Popujt
- **Të drejtat e reja** → Solidariteti





Karta e Kombeve të Bashkuara(1945)

↓
Deklarata e Përgjithshme e të drejtave të njeriut(1948)
Paktet mbi të drejtat (1966)

civile e politike ↙ ↘ ekonomike, sociale, kulturore

↓
Konventat mbi mbrojtjen e të drejtave specifike apo kategori specifike individësh

KONVENTAT MBI MBROJTJEN E TË DREJTAVE SPECIFIKE APO KATEGORI SPECIFIKE INDIVIDËSH

- Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e çdo forme **diskriminimi racor**.
- Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e çdo forme **diskriminimi ndaj grave**.
- Konventa mbi të drejtat e femijëve.
- Konventa shtesë mbi **shfuqizimin e skllavërisë**, tregtisë së skllavërve, dhe mbi format dhe praktikat të njehsueshme me skllavërinë.
- Konventa kundër **torturës** dhe dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo degraduese.
- Konventa mbi statusin e **refugjatit**.
- Konventa mbi parandalimin dhe shtypjen e **gjenocidit**.
- Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat e personave me **aftësi të kufizuar**.



NDËRKOMBËTARE MBI TË DREJTAT E NJERIUT

- Preambul
- Dispozitivi:
 - – Përkufizimet
 - – Të drejtat
 - – Organet
 - – Dispozitat mbi firmosjen dhe ratifikimin



Edukimi me të drejtat e njeriut
Pjesa III

Të drejtat e fëmijëve



DREJTAT E FËMIJËVE

**Konventa ndërkombëre mbi të
drejtat
e fëmijëve të Kombeve të
Bashkuara
(1989-1990)**



3 Protokollë shtesë:

- Përfshirja në konfliktet e armatosura
- Trafiku i fëmijëve, prostituimit dhe pornografisë minorile
 - Puna e minorenëve





- Neni 1


...me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.



KONVENTA NDËRKOMBËRE MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

Parimet themelore:

- **Mosdiskriminimi**
- **Interesi më i lartë i fëmijës**
- **Dëgjimi i mendimit të fëmijës**
- **Pjesëmarrja**



DISA TË DREJTA

- E drejta për shëndet
- E drejta për arsimim
- E drejta për tu dëgjuar
- E drejta për identitet
- E drejta për integrim familjar
- Ndalimi i shfrytëzimit të minorenëve
- E drejta e fëmijëve që i përkasin pakicave
- Liria e shprehjes, pjesëmarrjes, lirisë së mendimit dhe asociacionit



Kush duhet t'i respektojë?

- Meqenëse është një konventë ndërkombëtare, atëherë duhet të respektohet nga shtetet që e kanë ratifikuar konventën

- Vendet që kanë ratifikuar këtë konventë janë 192!
Praktikisht gjithë bota!



- Çdo vend bën ligje, krijon institucione dhe ndërmerr masa me qëllim garantimin e këtyre të drejtave.
- Meqenëse konventa sanksionon standarde minimale, ekzistojne disa dokumente të tjerë që mbrojnë të miturit ndaj dhunimeve specifike.



A respektohen vërtet këto të drejta?!



Neni 22

Shtetet Palë marrin masat e duhura për të siguruar që një fëmijë, i cili kërkon të marrë statusin e refugjatit ...të përfitojë nga mbrojtja dhe përkrahja humanitare e duhur



- Çdo vit në brigjet evropiane, kryesisht në Itali, Spanjë, dhe Greqi, mbërrijnë mijëra fëmijë të pashoqëruar të cilët përballen me vështirësi vërtet të mëdha
- Të rinjtë përbëjnë më se gjysmën e refugjatëve në botë dhe fëmijët janë mbi 20 milion. Shpeshherë, pikërisht se janë shumë të vegjël, nuk u njihet as statusi i refugjatit, sidomos kur bëhet fjalë për motivet politike.




Neni 32

Ndalimi i shfrytëzimit të punës të të miturve

- Sipas llogaritjeve të ILO, mbi 250 milion të mitur ndërmjet 5 dhe 14 vjeç punojnë sot në të gjithë botën; pjesa më e madhe e tyre gjenden në vendet në zhvillim (61% në Azi, 32% në Afrikë dhe 7% në Amerikën Latina): plantacione, fabrika lekurash, miniera, fasone, seleksionim mbeturinash, ndërtim apo punë shtëpiake. Orari i punës është zakonisht më i lartë se ai i të rriturve, mbi 60 orë javore, dhe në të kundërt paga është disa herë më e vogël



A young child, wearing a green shirt and shorts, is walking on a rocky, uneven path. The child is carrying a large, heavy load of dark, irregularly shaped objects, likely coal or charcoal, balanced on their head. The child's right hand is raised to touch the load. The background shows a hilly, overcast landscape with some green vegetation on the left and a large, dark, rocky area on the right. The overall scene suggests a difficult and labor-intensive environment.

***“Të gjithë fëmijët janë
titullarë të të njëjtave të
drejta, por për shumë prej
tyre mohimi i të drejtave
është rregulli i vërtetë i
jetës”.***

UNICEF